



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-086

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR FINANCIM NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË ARSIMIT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR FINANCIM
NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË ARSIMIT**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë marrëveshjen për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Ratifikohet marrëveshja për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën 1 të këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -086
24 shkurt 2016

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI